

VENDIM
Nr.1, datë 25.6.2011

PËR PËRPARËSITË NË ÇËSHTJET QË OFROHET NDIHMA JURIDIKE
PËR VITIN 2011 DHE 2012

Në mbështetje të nenit 10 shkronja “i” të ligjit nr.10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, me propozimin e Kryetarit të Komisionit,

KOMISIONI SHTETËROR PËR NDIHMËN JURIDIKE

VENDOSI:

I. Për ndihmën juridike dytësore, radha e prioriteteve për vitin 2011 dhe 2012 të jetë në rend zbritës si më poshtë:

- a) çështje gjyqësore me objekt regjistrim lindjeje;
- b) çështje gjyqësore për pensione pleqërie, pensione invaliditeti, pensione të parakohshme ose pagesa për personat me aftësi të kufizuar;
- c) çështje gjyqësore për heqje zotësie për të vepruar;
- ç) çështje gjyqësore për dhënie ndihme ekonomike;
- d) çështje gjyqësore për vendosje kujdestarie për fëmijët ose detyrime ushqimore për ta;
- dh) çështje gjyqësore të viktimës së dhunës në familje;
- e) zgjidhje martese;
- ë) çështje gjyqësore për korrigjime të akteve të gjendjes civile;
- f) çështje për të cilat Republika e Shqipërisë ka detyrim ligjor për shkak të nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku përcaktohet shprehimisht ofrimi i ndihmës juridike nga shteti shqiptar.
- g) rastet e diskriminimit të referuara nga Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të detyrimeve të memorandumit të bashkëpunimit, të nënshkruar nga KSHNJ dhe KMD.

II. Për ndihmën juridike parësore, radha e prioriteteve për vitin 2011 dhe 2012, të jetë në rend zbritës nëpërmjet dhënies së informacionit dhe këshillimit, si më poshtë:

- a) hartim dokumentacioni për marrje ndihme ekonomike;
- b) hartim dokumentacioni për gjendjen civile;
- c) hartim dokumentacioni për të përfutur strehim nga shteti;
- ç) hartim dokumentacioni për fushën e sigurimeve shoqërore, humbjen e aftësisë në punë, çështje të marrëdhënieve të punës ose zgjidhje martese.

III. Ndihma juridike parësore jepet nëpërmjet dhënies së informacionit për mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe nëpërmjet dhënies së asistencës, në hartimin e dokumenteve juridike.

Ndihma juridike dytësore jepet nëpërmjet dhënies së këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore dhe para organeve administrative shtetërore.

IV. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike parashikon në marrëveshjet e bashkëpunimit që lidh me organizatat jofitimprurëse mbulimin financiarisht, në mënyrë të pjesshme ose tërësore, të prioriteteve të ndihmës juridike sipas këtij vendimi.

V. Ngarkohet Kryetari i Komisionit të marrë masat e nevojshme administrative për respektimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Blegina Kodra